

Legjionaret/ Kaçe konfirmon interesimin e Arsenalit

nga AlbaniaSoccer

E premte, 01 Nentor 2013 22:08



Talenti shqiptar, Ergys Kaçe ka konfirmuar interesimin e Arsenalit, përmes rrjetit social, Facebook. Mesfushori është në ndjekje të disa skuadrave që e duan ta rrembejnë që në janar. Pas Chelseat, tani është shfaqur edhe Arsenali. Ai ka konfirmuar interesimin e gjigandeve anglez për shërbimet e tij. "Pas Chelseas, Veronas, Galatasarayt, Borussia Monchengladbach, Lazios, Udineses, Vitesses etj, kohët e fundit për mua ka shfaqur interesim dhe klubi i Arsenalit. Ndihem shumë i lumtur, tani të shikojmë", shkroi Kaçe në Facebook. PAOK dëshiron ta shesë sa më shpejt shqiptarin që ka krijuar probleme me tifozet në Selanik por nuk kanë ndërmend të mos përfitojnë prej tij një shume të majme eurosh.